



**GREEN Solution**

Tirana, Albania. Tel: +355 69 83 90 970

**PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE  
E RAPORTIT TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS**

**EMËRTIMI I AKTIVITETIT:  
GRUMBULLIMI, TRANSPORTIMI, RUAJTJA, MAGAZINIMI DHE TREGETIMI I  
VAJERAVE LUBRIFIKANTE.**

**VENDODHJA:  
QARKU VLORE, BASHKIA VLORE, NJESIA ADMINISTRATIVE NOVOSELE, FSHATI  
SKROFOTINE, RRUGA NACIONALE VLORE – FIER, GODINE E VELLEZERVE  
AGALLIU.**

Sipas shtojces 1 te Ligjit Nr. 10448, date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit", i ndryshuar:  
Menaxhimi i mbetjeve, Pika 5.10.a Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme. Te gjitha  
instalimet leje tipi B.

**Kërkues:  
Subjekti "VELLEZERIT AGALLIU / M" Sh.a  
NIPT: K77405201T**

**Ky raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis u hartua nga Studio:  
"GREEN Solution"**



**Ekspert Mjedis**

**Vanina Latifi**

**Eksperte Mjedis**

**Maj, 2017**

**TABELA:**

**STRUKTURA E RENDITJES DHE INFORMACIONIT QË PËRMBAN RAPORTI PARAPRAK I VNM**

**Hyrje**

<b>1. INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM DHE METODIKËN E ZBATUAR .....</b>	<b>9</b>
<b>2. PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI.....</b>	<b>10</b>
<b>3. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ. ....</b>	<b>18</b>
<b>4. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS.....</b>	<b>23</b>
<b>5. PËRSHKRIM I SHKARKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS.....</b>	<b>25</b>
<b>6. INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE.....</b>	<b>25</b>
<b>7. SHTRIRJA HAPËSINORE E NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDISIN E ZONËS.....</b>	<b>25</b>
<b>8. REHABILITIMI I MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSIA E KTHIMIT TË TIJ NË GJENDJEN E MËPARSHME.....</b>	<b>26</b>
<b>9. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.....</b>	<b>26</b>
<b>10. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË TILLË). ....</b>	<b>26</b>

## HYRJE

Kjo permbledhje joteknike e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, hartohet me kerkese te investitorit, Subjekti “VELLEZERIT AGALLIU / M” Sh.a, NIPT: K77405201T, me seli ne Vlore Novosele SKROFOTINE Rruga nacionale Vlore Fier, Godina e Vellezerve Agalliu, Skrofotine, Novosele, Vlore dhe me administrator Z. Sokol Agalliu. Objekti i vleresimit te ketij raporti eshte grumbullimi, transportimi, ruajtja, magazinimi dhe tregetimi i vajrave lubrifikante, i ndodhur ne Qarkun Vlore, Bashkia Vlore, Njesia Administrative Novosele, Fshati Skrofotine, Rruga Nacionale Vlore – Fier, Godine E Vellezerve Agalliu.

Permbledhja joteknike e VNM-se parashikon ndikimet ne mjedis nga funksionimi i ketij aktiviteti.

### Ortofoto te vendodhjes se aktivitetit



GRUMBULLIMI, TRANSPORTIMI, RUAJTJA, MAGAZINIMI DHE TREGETIMI I VAJERAVE LUBRIFIKANTE.  
QARKU VLORE, BASHKIA VLORE, NJESIA ADMINISTRATIVE NOVOSELE, FSHATI SKROFOTINE, RRUGA NACIONALE  
VLORE – FIER, GODINE E VELLEZERVE AGALLIU.



Koordinatat e objektit ne sistemin: Gaus-Kruge		
Nr.	Koordinatat Lindje Y	Koordinatat Veri X
1	4370994.57	4494625.67
2	4370880.31	4494705.04
3	4370860.97	4494677.32
4	4370978.41	4494597.43

Foto te aktivitetit



GRUMBULLIMI, TRANSPORTIMI, RUAJTJA, MAGAZINIMI DHE TREGETIMI I VAJERAVE LUBRIFIKANTE.  
QARKU VLORE, BASHKIA VLORE, NJESIA ADMINISTRATIVE NOVOSELE, FSHATI SKROFOTINE, RRUGA NACIONALE  
VLORE – FIER, GODINE E VELLEZERVE AGALLIU.



GRUMBULLIMI, TRANSPORTIMI, RUAJTJA, MAGAZINIMI DHE TREGETIMI I VAJERAVE LUBRIFIKANTE.  
QARKU VLORE, BASHKIA VLORE, NJESIA ADMINISTRATIVE NOVOSELE, FSHATI SKROFOTINE, RRUGA NACIONALE  
VLORE – FIER, GODINE E VELLEZERVE AGALLIU.



GRUMBULLIMI, TRANSPORTIMI, RUAJTJA, MAGAZINIMI DHE TREGETIMI I VAJERAVE LUBRIFIKANTE.  
QARKU VLORE, BASHKIA VLORE, NJESIA ADMINISTRATIVE NOVOSELE, FSHATI SKROFOTINE, RRUGA NACIONALE  
VLORE – FIER, GODINE E VELLEZERVE AGALLIU.



GRUMBULLIMI, TRANSPORTIMI, RUAJTJA, MAGAZINIMI DHE TREJETIMI I VAJERAVE LUBRIFIKANTE.  
QARKU VLORE, BASHKIA VLORE, NJESIA ADMINISTRATIVE NOVOSELE, FSHATI SKROFOTINE, RRUGA NACIONALE  
VLORE – FIER, GODINE E VELLEZERVE AGALLIU.





GRUMBULLIMI, TRANSPORTIMI, RUAJTJA, MAGAZINIMI DHE TREGETIMI I VAJERAVE LUBRIFIKANTE.  
QARKU VLORE, BASHKIA VLORE, NJESIA ADMINISTRATIVE NOVOSELE, FSHATI SKROFOTINE, RRUGA NACIONALE  
VLORE – FIER, GODINE E VELLEZERVE AGALLIU.



## 1. INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM DHE METODIKËN E ZBATUAR

### Përshkrimi qëllimit dhe objektivave të VNM

Ky Raport i Vleresimit të Ndikimit në Mjedis, është hartuar bazuar në legjislacionin mjedisor për VNM dhe ka për qëllim që të parashikojë, identifikojë, vleresojë dhe parandalojë ose minimizojë ndikimin në mjedis të projektit të propozuar.

Procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin:

- a) procesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- b) procesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Dokumenti bazë ku mbështetet procesi i VNM-së, është raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili, në varësi të ndikimeve të mundshme të projektit mund të jetë:

- a) raporti paraprak i VNM-së për projektet e shtojcës II të ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011;
- b) raporti i thelluar i VNM-së për projektet e shtojcës I të ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011;

Objektivat afatshkurter të VNM janë:

- Permiresim nga pikepamja mjedisore të projektit të propozuar;
- Siguron që burimet natyrore janë përdorur në mënyrën e duhur dhe me efikasitet;
- Siguron që është përzgjedhur alternativa më e mirë e vendodhjes së projektit.
- Siguron që janë marrë në konsideratë teknikat më të mira të disponueshme të teknologjisë së propozuar për tu aplikuar.
- Identifikon masat e duhura për zvogëlimin e ndikimeve të mundshme potenciale të projektit të propozuar;
- Mundëson informimin e vendim-marrësve, duke gjykuar në miratimin ose jo të projektit dhe kushteve që duhet të vendosen në aktin e miratimit.

Objektivat afatgjate të VNM janë:

- Siguron dhe mbron shëndetin e njeriut;
- Parashikon dhe parandalon ndryshimet/demtimitet e pakthyeshme të mjedisit;
- Ndikon në mbrojtjen e burimeve natyrore, peisazhet e natyres dhe komponentet perberes të ekosistemeve;
- Permireson aspektet sociale-ekonomike të projektit
- Ndihmon në realizimin e parimit të zhvillimit të qëndrueshem të mjedisit.

### Përshkrimi i përmbledhur i kuadrit ligjor mjedisor dhe institucional që lidhet me projektin

Legjislacioni mjedisor është hartuar për të mbrojtur dhe parandaluar ndotjen dhe demtimin e komponenteve të veçante dhe të rendesishme të mjedisit nga faktore të ndryshme, njerezore dhe natyrore.

Nder ligjet me kryesore në lidhje me këto projekt, mund të përmendim:

- Ligji Nr. 10431 datë 09.06. 2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit".
- Ligji Nr. 10440 datë 07.07. 2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis".
- Ligji Nr. 10448, date 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit".
- Ligji Nr. 10463 date 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".
- Ligji Nr.8897 datë 16.05.2002, "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja", i ndryshuar.
- Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit".
- Vendim Nr. 123, datë 17.2.2011 "Për menaxhimin e zhurmave".
- Ligji Nr.8906, datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura". I ndryshuar me:-Ligjin Nr.9868, datë 04.02.2008

- Vendim i KM Nr. 313, dt. 09.05.2012 “Per rregulloren e mbrojtjes se publikut nga shkarkimet ne mjedis”.
- Vendim i KM Nr. 13, date 04.01.2013 “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”.
- Vendim i KM Nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendim-marrjen mjedisore”.
- Vendim i KM Nr. 177, datë 31.3.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse”
- Vendim i KM Nr. 538 dt.26.05.2009 “Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet QKL dhe disa rregulla te tjera”
- Vendim i KM Nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL.
- Vendim i KM Nr. 676, datë 20.12.2002 “Për shpalljen e zonave te mbrojtura monument natyror”
- Vendim i KM Nr.432, datë 28.4.2010 Për zgjerimin e kufijve të rezervatit natyror të menaxhuar “Kune-Vain-Tale”
- Vendim Nr. 417, date 25.06.2014 “Per miratimin e tarifave te lejeve te mjedisit”
- Udhëzim Nr. 8, dt.27.11.2007 “Per nivelet kufi te zhurmave”.

#### **Shenim:**

Bazuar ne Ligjin Nr. 10448, date 14.07.2011 “Per lejet e mjedisit”, ky aktivitet, perfshihet ne listat e aktiviteve te cilat duhet te paisen me leje mjedisore te tipit A, B ose C. *(Konkretisht ne piken Menaxhimi i mbetjeve, Pika 5.10.a Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme)*. Te gjitha instalimet leje tipi B .

## **2. PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES SË ZONËS PËRRETH.**

Aktiviteti ne vleresim zhvillohet ne nje objekt tip kapanoni i cili eshte i ndertuar tashme dhe me infrastrukturen e nevojshme te ngritur. Objektet jane ndertuar mbi toka te cilat kane qene toka bujqesore te llojit “Are”. Bimesia e tokave bujqesore jane pikerisht kulturat bujqesore te cilat kultivohen nga bujqit e zones. Ne pergjithesi tokat e ketij rajoni jane te kripura, por plotesojne kushte te favorshme te zhvillimit te bimesise se zakonshme te rajonit te tilla si Drithra, jonxhe, perime, etj.

GRUMBULLIMI, TRANSPORTIMI, RUAJTJA, MAGAZINIMI DHE TREGETIMI I VAJERAVE LUBRIFIKANTE.  
QARKU VLORE, BASHKIA VLORE, NJESIA ADMINISTRATIVE NOVOSELE, FSHATI SKROFOTINE, RRUGA NACIONALE  
VLORE – FIER, GODINE E VELLEZERVE AGALLIU.



**Foto te bimesise se mbjelle nga subjekti**



**Përshkrimi i zonave të mbrojtura pranë vendit ku propozohet të zbatohet projekti përfshi edhe monumentet natyrore të mbrojtura me ligj.**

Ne rajonin e Vlores, zona e mbrojtur me e afert me proejktin ne vleresim eshte “Laguna e Nartes”, kufiri i se ciles arrin deri ne shtratin e Lumit Vjose dhe perfshin pjesen jugore te lumit, qe perkon edhe me territorin e Qarkut Vlore.

**Objekti ne vleresim ben pjese ne zonen e mbrojtur “Vjose-Narte”, Zona C.**

**Pershkrimi i zones se mbrojtur (Peizazhi i Mbrojtur “Vjose-Narte”(Kategoria V))**

Peizazhi ujqor/tokësor i mbrojtur ka një sipërfaqe të përgjithshme orej 19 738 ha, të përbërë nga:

Sipërfaqe ligatinore (sipërfaqe ujore, zona të lagëta, ranore/toka margjinale)	7225 ha;
Sipërfaqe pyjore	1167 ha;
Sipërfaqe bujqësore	7798 ha;
Sipërfaqe urbane	277 ha;
Sipërfaqe ujore	2985 ha;
Aeroporti	286 ha.

Peizazhi ujqor/tokësor i mbrojtur ka këto ndarje zonale:

a) Zona qendrore e ruajtjes së biodiversitetit (shënuar në hartë me shkronjën “A”) përfshin rezervatin e Pishë-Poros, lagunat e Kallenges, pyllin e Poros, Shamadurën, Limopuan, pyllin dhe ishujt e Zvërnecit. Brenda saj ka dy nënndarje (A1 dhe A2), që përcaktojnë mënyrën e administrimit. Zonat e nënndarjes A1 ruhen dhe mbrohen në mënyrë strikte. Zonat e nënndarjes A2 ruhen, por edhe përdoren për qëllime ripërtëritje natyrore.

b) Zonat e përdorimit tradicional (shënuar në hartë me shkronjën “B”), që nuk cenojnë brojtjen e natyrës dhe të biodiversitetit, përfshijnë tokat bujqësore (të Dellinjës, Zhukës dhe të aeroportit), kriporet dhe pjesën perëndimore të lagunës së Nartës. Brenda saj ka dy nënndarje (B1 dhe B2), për mënyrën e administrimit.



Në nënndarjen B1 zhvillohen veprimtari ekonomike tradicionale, si peshkimi, akuakultura, gjuetia, turizmi, bujqësia dhe blegtoria. Në nënndarjen B2 zhvillohet veprimtaria ekonomike tradicionale e nxjerrjes së kripës.

c) Zona e zhvillimit të qëndrueshëm (shënuar në hartë me shkronjën “C”) përmbledh fushën e Bilbilit, të Akernisë, Novoselës, Skrofotines, Panajasë dhe Nartës, si dhe kodrat e fshatrave Trevllazër, Llakatund, Kërkovë e Bestrovë. Në brendësi të kësaj zone mund të zhvillohen veprimtari ekonomike, si bujqësi, gjueti, blegtori, tregti, pemëtari, ndërtime etj., që nuk cenojnë natyrën dhe biodiversitetin.

ç) Zona e zhvillimit turistik (shënuar në hartë me shkronjën “D”).

GRUMBULLIMI, TRANSPORTIMI, RUAJTJA, MAGAZINIMI DHE TREGETIMI I VAJERAVE LUBRIKANTE.  
 QARKU VLORE, BASHKIA VLORE, NJESIA ADMINISTRATIVE NOVOSELE, FSHATI SKROFOTINE, RRUGA NACIONALE  
 VLORE – FIER, GODINE E VELLEZERVE AGALLIU.


### Harta e zones se mbrojtur te Lagunes se Nartes



**Monumentet Natyrore te Rrethit Vlore.(Sipas VKM 676)**

Nr.	Monumenti Natyror	Nr.	Monumenti Natyror
1	Qiparisi i Kambanores se Kishes se Vunoit	27	Shpella e Pirateve (Dhermi)
2	Lisat e Pilurit	28	Shpella e Odiseve (Surianit)
3	Rrapi i Kosmarit Kudhes	29	Shpella e Duk Gjonit
4	Rrapi i Palases	30	Kanioni i Gjipese
5	Rrapi i Shkolles nr.1	31	Bokerimat e Vunoit
6	Rrapi i Xhamise	32	Rrethi i Plakes (Brataj)
7	Rrapi i Çesmes (Mifol)	33	Ujevara e Ramices
8	Ilqet i Zarelit me (0,5 ha)	34	Dunat e Nartes
9	Rrapi i Kroit te Madh	35	Delta e Perroit te Palases
10	Rrapi Laze	36	Burim i kripur i Bashajt
11	Mbihipja e Çikes	37	Vali i Vranishtit (burim i madh)
12	Mbihipja aktive e Dukatit	38	Laguna Limopuo
13	Shkeputje e re aktive e Llogarase	39	Rrepet e Buronjave Kuç
14	Tarraca detare e Kusbabait	40	Pisha Flamur- Llogara
15	Tarraca detare e ishshetpise pushimit punetorve	41	Rrapi Mesaplikut
16	Gjiri dhe shpellat e Grames	42	Karthi i Terbaçit
17	Bariera Koralore e grykes se Diallit	43	Rrapi i Dukatit
18	Falezat e Sazanit	44	Rrepet e Izvorit
19	Shpella e Shengjergjit ose e Bletes	45	Rrapi i Tragjasit te Vjeter
20	Shpella e Ramices	46	Rrapi i Shenvarvares (Velçe)
21	Shpella e Velçes	47	Rrapi i Gurrave Smokthine
22	Shpellat e Boderit (Smokthine)	48	Rrapi i Madh ne Bashaj
23	Shpella e Haxhi Alise (Iliriane)	49	Rrepet e Drashovices
24	Shpella e shkruar	50	Ullinjte e Trubullit ne Karbunare
25	Shpella e Bilbilenjeve	51	Pylli i Zvernecit
26	Shpella e Porto Palermos		

### Zonat e mbrojtura në Republikën e Shqipërisë (Sipas faqes zyrtare të MM)





**GRUMBULLIMI, TRANSPORTIMI, RUAJTJA, MAGAZINIMI DHE TREGETIMI I VAJERAVE LUBRIFIKANTE.  
QARKU VLORE, BASHKIA VLORE, NJESIA ADMINISTRATIVE NOVOSELE, FSHATI SKROFOTINE, RRUGA NACIONALE  
VLORE – FIER, GODINE E VELLEZERVE AGALLIU.**

**RRJETI I ZONAVE TË MBROJTURA NË SHQIPËRI**

<b>MINISTRIA E MJEDISIT</b>						<b>VITI 2014-MARS</b>		
<b>Nr.</b>	<b>Kategoria</b>	<b>Qarku</b>	<b>Rrethi</b>	<b>Emëri i ZM</b>	<b>Miratimi</b>	<b>Nr.ZM</b>	<b>Sipërf. Ha</b>	
1	I	Kukës	Tropojë	Lumi i Gashit	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	3.000.0	
2	I	Gjirokastrë	Gjirokastrë	Kardhiq	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	1.800.0	
	<b>KATEGORIA I</b>	<b>Rezervat Strikt Natyror/Rezervat Shkencor - Kategoria I (RSN)</b>				<b>SHUMA I</b>	<b>2</b>	<b>4.800.0</b>
3		Shkodër	Shkodër	Thethi	VKM nr. 96, datë 21.11.1966	1	2.630.0	
4	II	Dibër	Dibër	Lura	VKM nr. 96, datë 21.11.1966	1	1.280.0	
5	II	Vlorë	Vlorë	Llogara	VKM nr. 96, datë 21.11.1966	1	1.010.0	
6	II	Korçë	Korçë	Bredhi i Drenovës	VKM nr. 96, datë 21.11.1966	1	1.380.0	
8	II	Kukës	Tropojë	Lugina e Valbonës	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	8.000.0	
9	II	Durrës	Krujë	Qafë Shtamë	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	2.000.0	
10	II	Dibër	Mat	Zall Gjoçaj	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	140.0	
11	II	Korçë	Korçë	Prespa	VKM nr. 80, datë 18.02.1999	1	27.750.0	
12	II	Vlorë	Sarandë	Butrinti	VKM nr.134, datë 20.02.2013	1	9.424.4	
13	II	Tiranë,Durrës		Mali i Dajtit	VKM nr.402, datë 21.06.2006	1	29.216.9	
		Tiranë	Tiranë	Mali i Dajtit	VKM nr.402, datë 21.06.2006		26.772.7	
		Durrës	Krujë	Mali i Dajtit	VKM nr.402, datë 21.06.2006		2.444.2	
14	II	Fier, Tiranë		Divjakë-Karavasta	VKM nr.687, datë 19.10.2007	1	22.230.2	
		Fier	Lushnjë	Divjakë-Karavasta	VKM nr.687, datë 19.10.2007		19.411.1	
		Fier	Fier	Divjakë-Karavasta	VKM nr.687, datë 19.10.2007		2.074.5	
		Tiranë	Kevajë	Divjakë-Karavasta	VKM nr.687, datë 19.10.2007		744.6	
15	II	Elbasan, Diber		Shebenik-Jabllanice	VKM nr.640, datë 21.05.2008	1	33.927.7	
		Elbasan	Librazhd	Shebenik-Jabllanice	VKM nr.640, datë 21.05.2008		33.760.1	
		Diber, Kukes	Bulqize	Shebenik-Jabllanice	VKM nr.640, datë 21.05.2008		167.6	
16	II	Gjirokastrë, Korçe		Bredhi i Hotovës-Dangelli	VKM nr.1631, datë 17.12.2008	1	34.361.1	
		Permet	Permet	Bredhi i Hotovës-Dangelli	VKM nr.1631, datë 17.12.2008		33.165.3	
		Korçe	Kolonjë	Bredhi i Hotovës-Dangelli	VKM nr.1631, datë 17.12.2008		1.195.8	
17	II	Vlorë	Vlorë	Karaburun-Sazan	VKM nr.289, datë 28.04.2010	1	12.428.0	
		Berat, Elbasan		Mali i Tomorit	VKM nr.432, datë 18.07.2012	1	24.723.1	
18	II	Berat	Berat	Mali i Tomorit	VKM nr.432, datë 18.07.2012		8.398.4	
		Berat	Skrapar	Mali i Tomorit	VKM nr.432, datë 18.07.2012		15.045.8	
		Elbasan	Gramsh	Mali i Tomorit	VKM nr.432, datë 18.07.2012		1.278.9	
	<b>KATEGORIA II</b>	<b>Park Kombetar - Kategoria II (PK)</b>				<b>SHUMA II</b>	<b>15</b>	<b>210.501.4</b>
19	III	Shqipëri	Shqipëri	BioMonumente Nr.	VKM nr.676, datë 20.12.2002	348	0.0	
20	III			GjeoMonumente Nr.	VKM nr.676, datë 20.12.2002	398	0.0	
				ShumaBio&Gjeo Nr.		<b>746</b>	<b>0.0</b>	
21	III	Gjirokastrë	Gjirokastrë	Bredhi i Sotirës	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	1.740.0	
22		Gjirokastrë	Gjirokastrë	Zhej	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	1.500.0	
23	III	Vlorë	Delvinë	Syrri i Kaltër	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	180.0	
24	III	Dibër	Dibër	Vlashaj	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	50.0	
				Shuma MonNatyre Nr.		4	0.0	
				Totali MonNatyre Nr	VKM nr.676, datë 20.12.2002	750	0.0	
	<b>KATEGORIA III</b>	<b>Monument Natyre - Kategoria III (MN)</b>				<b>SHUMA III</b>		<b>3.470.0</b>
25	IV	Vlorë	Vlorë	Karaburun	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	20.000.0	
26	IV	Korçë	Devoll	Cangonj	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	250.0	
27	IV	Berat	Skrapar	Bogovë	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	330.0	
28	IV	Korçë	Korçë	Krastafillak	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	250.0	
29	IV	Elbasan	Librazhd	Kuturman	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	3.600.0	
30	IV	Fier	Fier	Pishë Poro	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	1.500.0	
31	IV	Lezhë	Lezhë	Berzanë	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	880.0	
32	IV	Fier	Fier	Levan	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	200.0	
33	IV	Berat	Berat	Balloll	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	330.0	
34	IV	Elbasan	Elbasan	Qafë Bushi	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	500.0	
35	IV	Durrës	Durrës	Rrushkull	Urdhër MB nr.2, datë 26.12.1995		650.0	
36	IV	Vlorë	Delvinë	Rrezomë	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	1.400.0	
37	IV	Kukës	Has	Tej Drini Bardhë	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	30.0	
38	IV	Korçë	Kolonjë	Gërmenj-Shelegur	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	430.0	
39	IV	Elbasan	Librazhd	Polis	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	45.0	
40	IV	Elbasan	Librazhd	Stravaj	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	400.0	
41	IV	Elbasan	Librazhd	Sopot	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	300.0	
42	IV	Elbasan	Librazhd	Dardhë-Xhyrë	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	400.0	
43	IV	Shkodër	Shkodër	Liçeni i Shkodrës	VKM nr. 684, datë 02.11.2005	1	26.535.0	
44	IV	Lezhë	Lezhë	Kune-Vain-Taie	VKM nr.432, datë 28.04.2010	1	4.393.2	
45	IV	Lezhë	Kurbin	Patok-Fushëkuqe-Ishem	VKM nr.995, datë 03.11.2010	1	5.000.7	
46	IV	Diber, Kukes		Korab-Koritnik	VKM nr.898, datë 21.12.2011	1	55.550.2	
		Diber	Diber	Korab-Koritnik	VKM nr.898, datë 21.12.2011		20.663.4	
		Kukës	Kukës	Korab-Koritnik	VKM nr.898, datë 21.12.2011		34.886.8	
	IV/1	<b>Park Natyror Rajonal</b>						
47	IV/1	Diber	Mat	Liçeni i Ulzez dhe zona perreth tij	VKQ nr. 16, datë 03.04.2013	1	4.206.0	
	<b>KATEGORIA IV</b>	<b>Rezervat Natyror i Menaxhuar/Park Natyror - Kategoria IV (RNM)</b>				<b>SHUMA IV</b>	<b>23</b>	<b>127.180.1</b>
48	V	Korçë	Devoll	Nikolicë	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	510.0	
49	V	Korçë	Pogradec	Pogradec	VKM nr. 80, datë 18.02.1999	1	27.323.0	
50	V	Vlorë	Vlorë	Vjosë-Nartë	VKM nr.680, datë 22.10.2004	1	19.738.0	
51	V	Shkodër	Shkodër	Lumi Buna-Velipojë	VKM nr.682, datë 02.11.2005	1	23.027.0	

GRUMBULLIMI, TRANSPORTIMI, RUAJTJA, MAGAZINIMI DHE TREGETIMI I VAJERAVE LUBRIFIKANTE.  
QARKU VLORE, BASHKIA VLORE, NJESIA ADMINISTRATIVE NOVOSELE, FSHATI SKROFOTINE, RRUGA NACIONALE  
VLORE – FIER, GODINE E VELLEZERVE AGALLIU.

52	V	Tiranë,Diber,Elbasan		M.Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr.49, datë 31.01.2007	1	25,266.4
		Tirane	Tirane	M.Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr.49, datë 31.01.2007		13,213.6
		Diber	Mat	M.Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr.49, datë 31.01.2007		3,016.7
		Diber	Bulqizë	M.Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr.49, datë 31.01.2007		9,036.1
	KATEGORIA V	Peizazh I Mbrojtur - Kategoria V (PM)			SHUMA V	5	95,864.4
53	VI	Dibër	Dibër	Luzni-Bulaç	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	5,900.0
54	VI	Korçë	Kolonjë	Piskal-Shqeri	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	5,400.0
55	VI	Lezhë	Mirditë	Bjeshka e Oroshit	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	4,745.0
56	VI	Korçë	Pogradec	Guri i Nikës	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	2,200.0
	KATEGORIA VI	Zone e Mbrojtur e Burimeve të Natyrore të Menaxhuara - Kategoria VI (ZMBNM)			SHUMA VI	4	18,245.0
	TOTALI I ZM					16%	799

Sip. Republikës	2,874,800.00	ZM pa Sip.Detare	15.64%	446,799.7
		Sip. Detare, Ha	0.6%	13,261.2
		Karaburun-Sazan		12,428.0
		Butrint		833.2
		Sip. Bregdetare dhe Detare	%/Totalit ZM	25.95%
				119,401.5

Shkurtesat:

a	VKM	Vendim i Keshillit të Ministrave			
b	VKQ	Vendim i Keshillit të Qarkut			
c	MB	Ministria e Bujqesise			
d	ZM	Zone e Mbrojtur			

LISTA E ZONAVE RAMSAR

1	RAMSAR	Fier	Lushnje, Fier	Laguna Karavastase_Pisha Divjakes	VKM nr.413, datë 22.08.1994	Nr.Site 781, dt.29.11.1995	20,000.0
2	RAMSAR	Vlore	Sarande	Kanali Çukes-Butrint-Kepi Stillos	VKM nr.531, datë 31.10.2002	Nr.Site 1290, dt.28.3.2003	13,500.0
3	RAMSAR	Shkoder	Shkoder	Liçeni Shkodres-Lumi Bunes	VKM nr.683, datë 02.11.2005	Nr.Site 1598, dt.2.2.2006	49,562.0
4	RAMSAR	Korce	Korce,Devoll	Liçeni I Prespave	VKM nr. 489, dt. 13.06.2013	Nr.Site 2151, dt.03.07.2013	15,118.6
	TOTALI				%/Totalit Republikës	3.42%	98,180.6

DREJTORIA E BIODIVERSITETIT DHE ZONAT E MBROJTURA

SEKTORI I ZONAVE TË MBROJTURA

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 27, Tiranë.

[www.mjedisi.gov.al/](http://www.mjedisi.gov.al/)

## Lagunat Bregdetare

Lagunat bregdetare ose tokat e lagura në bregdet janë ekosistemet më të rëndësishëm të biodiversitetit shqiptar dhe për vlerat socioekonomike që ofrojnë. Vetëm në rreth 3% të sipërfaqes së vendit që mbulohet nga këto zona, përmbledhet rreth 70% e llojeve të ruazorëve të vendit. Ato paraqiten si një zinxhir që përshkon të gjithë vijën bregdetare ku përmendim nga veriu në jug Velipojën, sistemin e Kune-Vainit, Patokun, Rrushkullin, Karavastanë, Nartën, Orikumin, Butrintin, etj. Veçanërisht të rëndësishme shfaqen ato për grupin e shpendëve, kryesisht për dimërimin e shpendëve shtegtarë të ujit, dhe të amfibëve duke u ndjekur nga reptilët dhe gjitarët.


### 3. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË ZONËN E ZHVILLIMIT TË AKTIVITETIT DHE NË AFËRSI TË SAJ.

Ne zonen e zhvillimit te ketij aktiviteti nuk ka burime ujore te identifikuar. Konkretisht burimi ujqor me i afert eshte Laguna e Nartes rreth 3.3km ne vije ajrore ne jugperendim te objektit dhe Lumi Vjose rreth 5.8km ne vije ajrore ne lindje te objektit. Burim tjeterr ujqor eshte edhe deti Adriatik i cili ndodhet ne drejtimin perendimor ne nje distance rreth 9km ne vije ajrore. Burimi ujqor me i rendesishem eshte Laguna e Nartes e cila eshte edhe zone e mbrojtur. Ky lloj aktiviteti, duke qene edhe objekt ekzistues, por edhe aktivitet pa shkarkime te ujerave te ndotura, nuk ndikon ne demtimin e Lagunes.

**Pamje satelitore e pozicionimit te Zones se Mbrojtur “Laguna e Nartes” me objektin ne vleresim**



### Pamje satelitore e pozicionimit te burimeve ujore ne rajon




#### **Pershkrimi i shkurter fiziko-gjeografik i pellgut dhe karakteristikat kryesore te tij.**

Siperfaqja e pellgut te lumit Vjosa eshte rreth  $S=8.100\text{km}^2$ , nga te cilat rreth  $6.706\text{ km}^2$  pozicionohen ne brendesi te teritorit te Shqiperise kurse pjesa tjeter ndodhet ne Greqi. Rrjeti hidrografik i lumit te Vjosa ka nje gjatesi prej rreth 272km. Lumi Vjosa e ka vendburimin e tij ne Malet e Pindit ne teritorin e Greqise, ku lumi gjarperon ne nje lugine te ngushte dhe te thelle. Nje nga deget kryesore te lumit Vjosa eshte lumi Drino, me nje pellg ujembledhes me siperfaqe  $1.320\text{ km}^2$  nga te cilat rreth  $256\text{ km}^2$  te pozicionuar ne Greqi. Larmia litologjike, evolucioni morfologjik dhe morfogjenetik, levizjet neotektonike, etj, kane shkaktuar kontraste te medha midis sektoreve te lugines se lumit te Vjoses. Me hyrjen ne teritorin e Shqiperise gjeresia e lumit rritet. Megjitheate vecorite morfologjike te lugines se Vjoses ndryshojne shume gjate shtrirjes se saj si pasoje e ndertimit gjeologjik. Lugina peson zgjerime ne sektoret ku lumi nderpret ose pershkron struktura sinklinale, qe ndertohen nga shkembinjte terrigjene. Ngushtimet jane ne sektoret ku lumi can struktura antiklinale, te ndertuara kryesisht nga shkembinj gelqerore.

Nje nga karakteristikat e pellgut ujembledhes te lumit Vjosa eshte prezenca ne te te akuifereve karstike, te cilat sjellin nje prurje te bolleshme edhe gjate periudhes se thate. Me poshte japim disa karakteristika te tij : - Prurja vjetore  $5.550\text{ milion m}^3$ . - Prurja specifike  $26\text{ l/s.km}^2$ . - Periudha me e thate Gusht – Shtator. - Periudha me e lagesht Shkurt.

Lumi	Stacioni	Siperfaqja (km <sup>2</sup> )	Lartesia (m)	Debiti (m <sup>3</sup> /s)	Reshiet (mm)
Vjosa	Biovizhde	2170	1220	60.2	1260
Vjosa	Petran	2420	1190	62.2	1210
Vjosa	Permet	2810	1160	67.5	1220
Vjosa	Dragot	3470	1090	91.4	1320
Vjosa	Dorze	5420	963	158	1570
Vjosa	Mifol	6680	858	176	1520
Drino	Hormova	1300	748	39.0	1950









### Ujërat, Gjëndja e treguesve mjedisor, ndikimi në mjedis dhe tendenca

Monitorimi i cilësisë së ujërave sipërfaqësore, lumenj, liqene dhe zona bregdetare


Në lumenjte kryesore të vendit Drin, Bunë, Mat, Ishëm, Erzen, Seman dhe Vjosë monitorimi realizohet nga Agjencia Kombetare e Mjedisit (AKM), në 34 stacione duke përfaqësuar gjithë gjatesinë e lumit në rrjedhjen e sipërme, në rrjedhjen e mesme dhe në rrjedhjen e poshtme. Monitorimi i liqeneve Ohër, Shkodër, Prespë është realizuar në 6 stacione dhe 1 stacion në lagunën e Butrintit, kurse monitorimi i cilësisë së ujërave bregdetare të ndikuar nga shkarkimet urbane në 10 stacione në ne qytetet Durrës, Vlorë dhe Sarandë. Monitorimi është realizuar me frekuence 4 herë në vit për ujërat e lumenjve dhe të zonës bregdetare dhe 3 herë në vit për ujërat e liqeneve. Monitorimi i cilësisë së ujërave sipërfaqësor është realizuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Vlersimi i cilësisë së tyre përcaktohet në bazë të parametrave fizikokimikë duke i krahasuar me normat e lejuara të përcaktuara në Direktivën Kuadër të Ujit të BE.

Grafiket e rezultateve te matjeve te kryera per gjendjen e mjedisit ne disa lumenj te vendit, perfshi edhe Lumin Vjose(Inicialet Vj1, Vj2, Vj3, Vj4, Vj5).





Gjendja: Treguesit NO<sub>3</sub> në basenet lumore të Shqipërisë është e larte ose klasa I Trendi: Treguesit NO<sub>3</sub> në basenet lumore të Shqipërisë ne vite paraqitet ne vlera te ndryshme brenda basenit, por permbajtja e tyre ne ujerat e lumenjve eshte e ulet ne krahasim me normen e cilesise se mire.



Burimi i informacionit: Raporti i gjendjes se mjedisit per vitin 2014, Ministria e Mjedisit, Agjencia Kombetare e mjedisit(Faqja Zyrtare).

#### 4. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS.

##### Pershkrimi i aktivitetit

Aktiviteti ne vleresim eshte menaxhimi i mbetjeve, Stacion transferimi per mbetje te rrezikshme, i ndodhur ne Qarkun Vlore, Bashkia Vlore, Njesia Administrative Novosele, Fshati Skrofotine, Rruga Nacionale Vlore – Fier, Godine e Vellezerve Agalliu. Aktiviteti kryen grumbullimin, transportimin, ruajtjen, magazinimin dhe tregetimin e vajrave lubrifikante. Ne funksion te aktivitetit subjekti ka ne pronesi te tij nje siperfaqe trualli rreth 4850m<sup>2</sup>.

##### Lloji i ndikimeve të identifikuar (direkte dhe jo direkte)

Vleresimi i ndikimeve ne mjedis kryhet duke u bazuar mbi parimet e mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- Parimi i qasjes së integruar
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit
- Parimi “Ndotësi paguan”
- Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Ky vleresim kryhet ne baze te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 “Per vleresimin e Ndikimit ne Mjedis” dhe VKM Nr. 13, date 04.01.2013 “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis” dhe ka si synim identifikimin, vleresimin dhe parandalimin e ndotjes se mjedisit, me qellim mbrojtjen e mjedisit. Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e dëmtimi. Kjo përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Objektivat e mbrojtjes së mjedisit janë:

- a) Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera
- b) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- c) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
- d) Përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;
- e) Ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;
- f) Mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;



g) Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut.

### **Ndikime te rendesishme gjate zhvillimit te aktivitetit**

#### **Shkarkime ne uje**

Nuk do te kete shkarkime ne ujera. Vajerat lubrifikant do te grumbullohen nga subjektet te ndryshme te cilat prodhojne keto vajera, me pas nepermjet automjeteve perkatese do te transportohen per ne subjekt. Keto vajera do te ruhen dhe magazinohen ne fuci perkatese derisa te arrihet nje sasi prej 50 deri ne 100 ton, me pas sipas kerkesave te tregut te jashtem keto vajera do te eksportohen. Nuk do te kemi shkarkime te ujerave ne mjedisin perreth.

#### **Emetimet ne ajer**

Nuk do te kete ndotje ne ajer. Vajerat do te ruhen dhe magazinohen ne fuci apo konteniere perkates. Nuk ka emetime ne ajer, as aroma te pakendeshme.

#### **Zhurmat dhe vibrimet**

Zhurmat qe do te prodhohen do te vijne kryesisht nga mjetet e transportit. Zhurmat e prodhuara nga vete personat qe punojne ne kete objekt nuk jane te vleresueshme. Punëtorët që do të ndodhen në mjedise ku niveli i zhurmave e tejkalon limitin mund të perdorin masa mbrojtese per shqisat e degjimit. Kjo duhet te kihet parasysh nga drejtuesi teknik i objektit. Nuk ka vibrime ne kete objekt. Nuk ka procese pune dhe industrie prodhuese apo perpunuese.

#### **Ndikimi ne toke**

Keto procese pune ne kete aktivitet nuk ndikojne aspak ne toke. Sheshi ne te cilin kryhet puna eshte i shtruar me beton. Nuk kemi depertim te vajerave lubrifikante ne toke.

#### **Ndikimi ne Biodiversitet**

Ky aktivitet bene pjese ne zonen e mbrojtur “Vjose-Narte”, Zona C. Zona e mbrojtur ndodhet rreth 3.3km ne vije ajrore ne jugperendim te objektit.

#### **Mbetjet e prodhuara**

Mbetjet qe krijohen jane mbetje te ngurta urbane qe prodhohen nga aktiviteti human. Keto mbetje hidhen ne kontenierin perkates te zones. Nuk vleresohet aktivitet me mbetje te ngurta. Vajerat lubrifikante grumbullohen, transportohen, ruhen, magazinohen dhe tregetohen jashte dhe brenda vendit.

#### **Ndikime te tjera**

Ndikimi i ketij aktiviteti ne mjedisin social, eshte pozitiv persa i perkete punesimit.

## **5. PËRSHKRIM I SHKARKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS.**

Informacion për shkarkimet në mjedis.

Ndikime te rendesishme gjate zhvillimit te aktivitetit

Nuk do te kete shkarkime ne ujera. Vajerat lubrifikant do te grumbullohen nga subjektet te ndryshme te cilat prodhojne keto vajera, me pas nepermjet automjeteve perkatese do te transportohen per ne subjekt. Keto vajera do te ruhen dhe magazinohen ne fuci perkatese derisa te arrihet nje sasi prej 50 deri ne 100 ton, me pas sipas kerkesave te tregut te jashtem keto vajera do te eksportohen. Nuk do te kemi shkarkime te ujerave ne mjedisin perreth.

Nuk do te kete ndotje ne ajer. Vajerat do te ruhen dhe magazinohen ne fuci apo konteniere perkates. Nuk ka emetime ne ajer, as aroma te pakendeshme.

Zhurmat qe do te prodhohen do te vijne kryesisht nga mjetet e transportit. Zhurmat e prodhuara nga vete personat qe punojne ne kete objekt nuk jane te vleresueshme. Punëtorët që do të ndodhen në mjedise ku niveli i zhurmave e tejkalon limitin mund të perdorin masa mbrojtese per shqisat e degjimit. Kjo duhet te kihet parasysh nga drejtuesi teknik i objektit. Nuk ka vibrime ne kete objekt. Nuk ka procese pune dhe industrie prodhuese apo perpunuese.

Keto procese pune ne kete aktivitet nuk ndikojne aspak ne toke. Sheshi ne te cilin kryhet puna eshte i shtruar me beton. Nuk kemi depertim te vajerave lubrifikante ne toke.

Ky aktivitet bene pjese ne zonen e mbrojtur “Vjose-Narte”, Zona C. Zona e mbrojtur ndodhet rreth 3.3km ne vije ajrore ne jugperendim te objektit.

Mbetjet qe krijohen jane mbetje te ngurta urbane qe prodhohen nga aktiviteti human. Keto mbetje hidhen ne kontenierin perkates te zones. Nuk vleresohet aktivitet me mbetje te ngurta. Vajerat lubrifikante grumbullohen, transportohen, ruhen, magazinohen dhe tregtohen jashte dhe brenda vendit.

Ndikimi i ketij aktiviteti ne mjedisin social, eshte pozitiv persa i perkete punesimit.

## **6. INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE.**

Nuk ka ndikime ne mjedis gjate funksionimit te aktivitetit. Nuk kemi shkarkime ne ujera, ne ajer, ne toke. Persa i perket vajerave lubrifikante ato grumbullohen nga subjekte te cilat jane aktivitet i prodhimit te tyre, me pas nepermjet automjeteve perkatese do te transportohen per ne subjekt. Keto vajera do te ruhen dhe magazinohen ne fuci perkatese derisa te arrihet nje sasi prej 50 deri ne 100 ton, me pas sipas kerkesave te tregut te jashtem keto vajera do te eksportohen. Ky aktivitet nuk eshte percaktuar me afat per funksionimin e tij, ai do te funksionoje pa afat te caktuar.

## **7. SHTRIRJA HAPËSINORE E NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDISIN E ZONËS**

Ne kushte normale te zhvillimit te aktivitetit, nuk vleresohen ndikime te rendesishme te cilat mund te shkaktojne ndotje ne distance te medha. Per administrimin e vajrave lubrifikante qe grumbullohen nga subjekte te ndryshme deri ne magazinimin dhe tregtimin e tyre duhet te respektohen me rigorozitet kushtet teknike te ruajtjes dhe transportimit te tyre.

## **8. REHABILITIMI I MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSIA E KTHIMIT TË TIJ NË GJENDJEN E MËPARSHME.**

Aktiviteti zhvillohet ne kushte te mira dhe higjenike. Subjekti disponon makineri dhe mjete te sigurta e bashkohore ne perputhje me standartet e kerkuara. Procesi i menaxhimit te vajrave lubrifikante eshte i mireorganizuar. Punonjesit dhe personeli tjetere jane te trajnuar dhe kualifikuar per proceset e punes qe kryejne ne aktivitetet. Per monitorimin e problemeve mjedisore subjekti do te disponoje regjistra te vecante.

## **9. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.**

Ne menyre te pergjithshme do te japim disa prej masave qe duhet te zbatohen nga investitori. Disa prej masave kryesore qe do te ndermerren jane permendur ne menyre te permbledhur si me poshte:


- Te mos shkarkohen ne asnje menyre ujera me perberje karburantesh.
- Te zbatohen kushte te larta sigurie dhe te jene ne gadishmeri pajisjet e mbrojtjes nga zjarri. Punonjesit te jene te trajnuar dhe te dine te perdorin pajisjet.
- Te kontrollohen mjetet e transportit dhe te pastrohen rregullisht.
- Te kryhet rregullisht pastrimi i fucive apo konteniereve perkatese ne te cilen magazinohen vajerat lubrifikante.
- Te mos shkarkohen ne asnje menyre vajera lubrifikante ne mjedisin e zones.

## **10. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË TILLË).**

Ky projekt nuk prek zonat kufitare dhe si rrjedhoje edhe ndikimi i tij nuk shkakton demtim te mjedisit nderkufitar. Projekti nuk ndikon ne cenimin e sigurise se jetes dhe shendetit te shteteve fqinje. Nuk ndikohet cilesia e ajrit ne kontekstin nderkufitar. Per kete kapitull, nuk kryhen vleresime dhe analiza te detajuara per shkak te vendodhjes se projektit ne brendesi te kufirit shteteror dhe distances qe ai ruan me kufirin dhe shtet fqinje.

**ANEKS:**

**Fragment nga Harta Topografike 1:25000 (Nomeklatura: (K-34-123-(80-A)**



Koordinatat e objektit ne sistemin: Gaus-Kruge		
Nr.	Koordinatat Lindje Y	Koordinatat Veri X
1	4370994.57	4494625.67
2	4370880.31	4494705.04
3	4370860.97	4494677.32
4	4370978.41	4494597.43